UDHËZIM
Nr. 28, datë 31.12.2025

PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 14.1.2020, "PËR DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, DEGËVE TË TYRE, NJËSIVE KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN OSE BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës; të neneve 30 dhe 35, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; të vendimit nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre", të ndryshuar, dhe të shkronjës "th", të pikës 2, të urdhrit nr. 580, datë 11.11.2025, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave zëvendësministrit të Arsimit, znj. Armela Baka",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

a) Pika 2, e shkronjës F, kreu IV, ndryshon si më poshtë:

"2. Për kuotat në programet e studimit për fitimin e gradës shkencore "Doktor', IAL-ja aplikon brenda datës 30 nëntor për atë vit akademik dhe së bashku me aplikimin ngarkon dokumentacionin shoqërues, sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.";

b) Pas pikës 5/7, të kreut VI, të shtohet pika 5/8 me përmbajtjen si më poshtë:

"5/8 Përjashtimisht, aplikimet për programet e studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" për vitin akademik 2025–2026, do të pranohen deri më 22 janar 2026.".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
Armela Baka